



Si të fitoni diplomën e shkollës së mesme në Ohajo

Klasa e 2020

Si nxënës që ka hyrë në klasën e 9-të mes datave 1 korrik 2016 dhe 30 korrik 2017, ju keni mënyra të ndryshme për të fituar diplomën e shkollës së mesme në mënyrë që të përparoni në arsimin tuaj ose në karrierë.

- Duhet të përfundoni dhe fitoni një minimum shtetëror prej 20 kreditesh për subjektet specifike. Gjithashtu, duhet të merrni mësim në njohuri ekonomike dhe financiare dhe të përfundoni të paktën dy semestra nga artet e bukura. Distrikti juaj mund të ketë më shumë kërkesa për diplomimin. Këtë informacion e ka këshilluesi i shkollës suaj.
- Ju duhet të demonstroi atë që keni mësuar. Në ligjin e Ohajos ka tre mënyra për t'u ndjekur.

1. Testet shtetërore të Ohajos

Fitoni 18 nga 35 pikët në shtatë teste shtetërore në fund të kursit. Për çdo test mund të fitoni deri në pesë pikë. Ju nevojitet një minimum prej katër pikësh në matematikë, katër pikë në artet gjuhësore të gjuhës angleze dhe gjashtë pikë në shkencë dhe shkenca sociale.

2. Kredencialet e njohura nga industria dhe rezultati në testin e gatishmërisë për të dalë në tregun e punës

Fitoni një kredencial të njohur nga industria ose një grup kredencialesh që arrijnë në total 12 pikë dhe fitoni rezultatin e kërkuar në testin WorkKeys. Ohajo ju paguan për ta bërë testin në kohë. Disa distrikte ofrojnë programin "vetëm për të moshuarit" përmes të cilit mund të fitoni kredencialet në një vit shkollor.


3. Testet për gatishmërinë për kolegji dhe për karrierë

Fitoni rezultate pa kompensim* në matematikë dhe anglisht në provimet ACT ose SAT. Distrikti juaj zgjedh ACT ose SAT. Do të zhvilloni falas vetëm një provim mbarështetëror në pranverë në klasën e 11-të.

*Presidentët e universitetit të Ohajos i caktojnë këto rezultate, të cilat janë subjekt i ndryshimeve.

- Nëse nuk plotësoni asnjë prej mënyrave të mësipërme, ligji i Ohajos ju ofron dy opsione shtesë për të fituar diplomën e shkollës së mesme. Ato shpjegohen në anën tjetër të kësaj faqeje faktesh.

Gjeni më shumë detaje rreth diplomimit në education.ohio.gov/graduation dhe lokalizoni seksionin për klasën e diplomimit tuaj.



Flisni me këshilluesin e shkollës në fillim të vitit shkollor rreth mënyrës suaj të diplomimit dhe suksesit tuaj në të ardhmen.

Opsionet shtesë të diplomimit të disponueshme për klasën e vitit 2020

Nxënësit që kanë hyrë në klasën e 9-të pas 1 korrikut 2014, janë të parët që fitojnë diplomën sipas kërkesave të reja të diplomimit. Veç plotësimit të kërkesave të kurrikulës së shkollës së mesme, nxënësit në Ohajo duhet të plotësojnë një prej [tri mënyrave ekzistuese](#) për të fituar një diplomë të shkollës së mesme.

Për të mbështetur tranzicionin në kërkesat e reja, Asambleja e Përgjithshme miratoi opsionet e përkohshme të diplomimit për nxënësit në klasën e 2018.

Legjislacioni i fundit i shtriu opsionet shtesë të diplomimit edhe në klasat e 2019 dhe 2020, siç jepet më poshtë.

Kini parasysh se ligji shtetëror ka modifikuar kriteret e disponueshme për klasën e vitit 2020 dhe jo të gjitha kriteret origjinale disponohen për studentët në klasën e vitit 2020.

Departamenti pret që shumica e nxënësve të plotësojnë një prej tre mënyrave ekzistuese, dhe distriktet duhet të vazhdojnë të punojnë me nxënësit, sipas nevojës, për të plotësuar këto kërkesa. Këto opsione ofrojnë një mundësi që nxënësit që nuk plotësojnë një prej tre mënyrave ekzistuese për diplomim të fitojnë diplomë.

Dy opsionet shtesë të diplomimit për klasën e vitit 2020 janë:

Opsioni 1

Nxënësit që hyjnë në klasën e 9-të mes 1 korrikut 2016 dhe 30 qershorit 2017, kanë të drejtën të përdorin opsionet e modifikuara të diplomimit më poshtë. Nxënësit duhet të kryejnë dhe të kalojnë kurset që janë në kërkesat e kurrikulës dhe të kryejnë të shtatë provimet në fund të kursit.

Nëse nxënësi merr rezultat "1" ose "2" në ndonjë test të matematikës ose të anglishtes, duhet ta kryejë sërish tekstin të paktën një herë.

Gjithashtu, duhet të plotësoni **të paktën dy** prej kërkesave të mëposhtme:

- Të fitoni një GPA prej 2,5 nga 4,0 në të gjitha kurset e kryera **gjatë klasës së 12-të** (duhet të përfundoni të paktën katër kurse të plota vjetore, ose ekuivalente);
- Të përfundoni një projekt studimor të pavarur gjatë klasës së 12-të që plotëson kriteret e përcaktuara nga proceset e udhëzimit dhe vlerësimit të Departamentit të Arsimit të Ohajos (**udhëzimi i disponueshëm nga 31 maji 2019**);
- Gjatë klasës së 12-të, përfundon një përvojë pune ose shërbimi në komunitet që arrin në total 120 orë, siç përcaktohet nga Departamenti i Arsimit të Ohajos dhe Zyra e Guvernatorit për Transformimin e Forcës Punonjëse (**udhëzimi i disponueshëm nga 31 maji 2019**);
- Të fitoni tre ose më shumë kredite [College Credit Plus](#) në çdo moment gjatë shkollës së mesme;
- Të fitojë kredite për një kurs Advanced Placement (AP) ose International Baccalaureate (IB) dhe të arrijë një rezultat provimi AP prej 3 ose më shumë pikësh ose rezultat provimi IB prej 4 ose më shumë pikësh në çdo moment gjatë shkollës së mesme;
- Të arrijë një rezultat provimi WorkKeys prej 3 pikësh në secilin prej tre seksioneve të testit;
- Të fitoni një [kredencial të njohur nga industria](#) të miratuar nga bordi shtetëror ose kredenciale që barazohen me të paktën tre pikë;
- [Të plotësoni kërkesat e vulës së gatishmërisë së OhioMeansJob.](#)


Opsioni 2

Nxënësit duhet të kryejnë dhe të kalojnë kurset që janë në kërkesat e kurrikulës dhe të kryejnë të shtatë provimet në fund të kursit. Nxënësit duhet të përfundojnë programin teknik të karrierës që përfshin të paktën katër kurse në një drejtim të vetëm karriere dhe të kryejnë **të paktën një** nga opsionet më poshtë:

- Të fitojnë një rezultat total I aftë ose më të mirë bazuar në provimet teknike të karrierës ose modulet e testit;
- Të fitojnë një kredencial të njohur nga industria ose kredenciale që janë baraz me 12 pikë;
- Të kryejnë një përvojë në vëndin e punës që arrin në total 250 orë me vërtetim për vlerësime pozitive.

PYETJE?

Nëse keni pyetje rreth kërkesave të diplomimit, telefononi në (614) 466-1317 ose dërgoni një email në gradrequirements@education.ohio.gov.



Flisni me këshilluesin e shkollës në fillim të vitit shkollor rreth mënyrës suaj të diplomimit dhe suksesit tuaj në të ardhmen.